



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[31.12.2020]

OPERATORIT EKONOMIKË “ALB BUILDING”

**TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Asim Vokshi, ndertesa nr.14, hyrja 4,
apartamenti 6, kodi postar 1016**

Procedura e prokurimit: Pune/ Procedure e Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-75502-10-14-2020

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Ndërtim Rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të
tij”, me fondin limit 1.479.800.353,50 lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së, REF-75502-
10-14-2020, Afati i kontrates 15 muaj**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve 19 Tetor 2020 [Nr.89]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.“ Alb Building”

NUIS: J69102508C

**Vlera: 1.402.652.826,75 (nje miliard e katerqind e dy milion e gjashteqind e pesedhjetë e dy
mijë e teteqind e njetë e gjashtë presje shtatedhjet e pese) Leke**



2.“ BE-IS & VELLEZRIT HYSA& ERGI & ROSI S.P.A ALBANIA”

NUIS: K71412003A / K12911201C / K02727229P / L42404005A

Vlera: 900.897.065 (nenteqind milion e teteqind e nentedhjete e shtate mije e gjashtedhjete e pese) leke

3. “GENER 2”

NUIS: K58615301M

Vlera: 961.394.069,50 (nenteqind e gjashtedhjete e nje milion e treqind e nentedhjete e kater mije e gjashtedhjete e nente presje pesedhjete) leke

4. “ GECI”

NUIS: K71829801O

Vlera: 1.047.820.950 (nje miliard e dyzete e shtate milion e teteqind e njezete mije e nenteqind e pesedhjete) leke

5. “ALB –STAR”

NUIS: K37209201G

Vlera: 1.417.963.621,20 (nje miliard e katerqind e shtatembedhjete milion e nenteqind e gjashtedhjete e tre mije e gjashteqind e njezete e nje presje njezete) leke

6. “VEGA & Alko IMPEX GENERAL CONSTRUCTION

NUIS: K01524006L / K91628013D

Vlera: 1.432.441.859 (nje miliard e katerqind e tridhjete e dy milion e katerqind e dyzete e nje mije e teteqind e pesedhjete e nente) leke

7. “GJIKURIA”

NUIS: J62903456H

Vlera: 1.457.653.774,5 (nje miliard e katerqind e pesedhjete e shtate milion e gjashteqind e pesedhjete tre mije e shtateqind e shtatedhjete e kater presje pese) leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.“ BE-IS & VELLEZRIT HYSA& ERGI & ROSI S.P.A ALBANIA”

NUIS: K71412003A / K12911201C / K02727229P / L42404005A

2.“GENER 2”

NUIS: K58615301M



3.“ GECI”

NUIS: K718298010

4. “VEGA & Alko IMPEX GENERAL CONSTRUCTION

NUIS: K01524006L / K91628013D

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I.Bashkimi I Operatoreve ekonomik “BE-IS & VELLEZRIT HYSA& ERGI & ROSI S.P.A ALBANIA”, nuk kualifikohet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumnetet e tenderit, arsyet e skualifikimit jane:

- **Operatori ROSI** sipas preventivit te ndarjes se punimeve ka marre përsipër te kryeje punimet e rrjetit te KUSH, Sinjalistiken rrugore, punimet per gjelbërimin, punimet e ndriçimit (pjesërisht). Ky operator nuk përmbush kriterin nr. 2.3.11 mbi disponibilitetin e makinerive pasi sipas Shtojces 10 nuk disponon makinerinë e vijëzimit me te cilën duhet te kryeje nje pjese te konsiderueshme te punimeve te cilat është angazhuar sipas kontratës se BOE.

- Sipas deklarates shtojces se mjeteve per plotesimin e kriterit 2.3.11 , operatori ekonomik Rosi albania dshh ka deklaruar nyje inerte e levizshme gjithashtu ka paraqitur dokumentacion ne sistemin e elektronik per permbushjen e ketij kriteri fature nr 699876 , date 10.12.2010 por nuk ka paraqitur dokumentacion ne sistemin e elektronik qe te provoje se disponon leje mjedisore KODI III.1.B per kete nyje . Pra operatori ekonomik Rosi albania dshh pjese e bashkimit te operatoreve nuk përmbush kriterin per Impiante per thyerje dhe seleksionim materiale inertesh , e paisur leje mjedisore kodi III.1.B, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

- Operatori nuk përmbush kriterin 2.3.1/a dhe kriterin 2.3.1/b per punët e ngjashme pasi sipas kontratës se bashkëpunimit te BOE operatori ka marre përsipër te kryeje punimet e ndërtimit te perdes me pilota me diametër 0.6m dhe 0.8m. Operatori dështon te plotesoje kriterin teknik per shkak se ne eksperiencën e ngjashme nuk ka sasinë e nevojshme te punimeve te ndërtimit te perdeve me pilota vendosur ne DST “*jo me pak se 50% e volumit te preventivit per zerat: Punime shpimi me sonde pilota me diameter jo me te vogel se 80 cm (ose perde mbajttese betoni dhe kolona çimentimi ekuivalent)*”

- **ERGI - Makinaria e Vijeimit e ERGIT** me nr. Fature 681262 eshte blere ne vitin 2003 (e pa shoqëruar me fatura e zhdoganimit apo dokument tjetër identifikues) nga nje subjekt qe ne pershkrimin e QKR sipas ekstraktit historik ka patur veprimtari qe prej themelimit vetëm ne kete fushe: *Organizim i lojrave te fatit per te rritur dhe femije, llotot, llotarite e numrave, llotarine e çastit, te lojrave automatike e jo automatike.*

- Nga deklarimi i operatorit per kontrata aktive sipas shtojcës 11 rezulton se ka aktivitet ne bashkitë Mallakaster dhe Dropull per te cilat nuk ka depozituar informacion mbi shlyerjen e detyrimeve te taksave vendore ne këto bashki, duke mos përmbushur kriterin 2.2.3 te Kushteve te veçanta te DST.



- **Operatori BE-IS** shpk ka marre persiper sipas preventivit ndares ne BOE punimet e germimit, pjesisht mbushjen dhe nje pjese te paketes se shtresave rrugore, punime hekuri e betoni komplekse per nenkalimin. Puna e ngjashme e depozituar nga ky operator konsiston kryesisht ne ndertim ujesjellesash, linja elektrike dhe rikonstruksione rruges. Punet e ngjashme te depozituara nga operatori nuk permbushin kriteret sipas pikes 2.3.1/a dhe 2.3.1/b pasi operatori nuk tregon eksperiencen e nevojshme per te realizuar punimet per ndertimin e nje nje rrugore ne disnivel te kategorisë A (dukshem shume here me komplekse sesa puna e ngjashme e depozituar). Operatori madje nuk ka treguar se ka eskperience te mirefillte ne ndertim rruges e aq me pak ne ndertimin e veprave te artit ne seksione rrugore.

- Operatori ekonomik rezulton se per vitet 2019-2020 ka ushtruar aktivitet ne bashkinë e Elbasanit (Rikonstruksioni i Rruges Ali Caushi) per te cilën nuk ka depozituar vërtetimin e shlyerjes se detyrimeve vendore, duke mos përmbushur kriterin 2.2.3 te Kushteve te veçanta te DST.

- **Per te gjithë Operoret Kriteri 2.3.11 – Makinerite**

Ne dst eshte kerkuar : “ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.”

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Automjetet e marra me qira nga te tretet nuk disponojnë certifikatat perkatese per transportin per te trete.

- **Vellezerit Hysa**

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton AA410PV, AA659PU, AA610ST (nuk disponon certifikate), AA167ES.

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton AA457ZB (nuk disponon certifikate)



Kamion me vinç vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 5 ton AA978IV
Autobot Uji AA041HE nuk disponon certificate transporti.

BE-IS

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton AA542GX, AA426HJ.

Autobetoniere TR5961K, TR8638T, TR4047R.

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton AA016VV.

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton AA542GX

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton AA426HJ

Autobot uji AA095VO (vetëm certificate transporti ndërkombëtar mallrash te rrezikshme)

Autobetoniere AA890NF

Autobetoniere AA406MA

Autobetoniere AA270 JH

Autobetoniere AA066LN

Kamion AA203JL

Kamion PR2160B

II. Operatori ekonomik “GENER 2”, nuk kualifikohet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumnetet e tenderit, arsyet e skualifikimit jane:

GENER 2

- Operatori ka dështuar te plotesoje kriterin e kushteve te veçanta mbi kapacitetin teknik
*2.3.11 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike **qe ka ne dispozicion** apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20ton me targa AA065SK, AA106ME, AA107ME, AA113ME, AA453MF, AA455MF, AA480RR, AA581ME, AA580ME.

- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20ton AA872ML, AA947YC.

- Kamioncine deri ne 3.5 ton. AA465MF

- Graider ABMT04

- Autobot Uji AA703OM

- Ekskavator me zinxhirë me peshe mbi 20ton Liebherr R906LC

- Buldozer me fuqi mbi 100Ph R35263

- Rrul ngjeshës me peshe operative mbi 15ton Hamm AG H1761376, Hamm H1610984

Mjetet e mësipërme janë te angazhuara ne kontrata te tjera ne proces ekzekutimi me ARRSH.

• Operatori ekonomik ka deshtuar te plotesoje piken 2.2.3 *Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim (shoqëruar me mandat pagese) te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2019 pasi sipas ekstraktit te QKR “Ekstrakt i regjistrimit kombetar per te dhenat e subjektit Shoqeri me Përgjegjësi te Kufizuar” ka*



aktivitet ne keto qytete pika 19. Vende te ushtrimit te aktivitetit) Shkoder (i shtuar si vend ushtrimi aktiviteti ne vitin 2019 per kontratën Rikonstruksion i rrugës se Velipojes segmenti harku i Berdices-Baks) per te cilin O.E. nuk ka depozituar pranë sistemit elektronik vërtetimin përkatës per shlyerjen e detyrimeve dhe tarifave vendore.

- O.E. rezulton debitor ne Bashkine Tirane me vlere 47,197,316 leke. O.E. dhe B.T janë ne proces gjyqësor per kete shume dhe O.E ka depozituar garancinë bankare përkatëse.

III.Operatorëve ekonomik “ GECI”, nuk kualifikohet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumnetet e tenderit, arsyet e skualifikimit jane:

Operatori Ekonomik nuk plotëson Kushtet e veçanta 2.3.11

- *Ne dst eshte kerkuar : “ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.”*
- Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.
- Makinerite e mëposhtme te mara me qira nuk disponojnë certifikatat e transportit per te trete.
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton AA463DY, AA159HX
Autobot Uji AA694SE
Autobetoniere TR1065N, TR1067N, AA263RY, TR6491N, TR1063N, TR1498G, TR4806N, TR4807N, AA129VN.
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton AA627TM + AGR210, AA028VG + AFR770
Autobitumatrice AA230UL
Kamion me vinç mbi 5 ton AA127AS (nuk disponon licence transporti mallrash)



- Operatori nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues (vetëm deklaruar tek shtojca 10) makinerinë e tipit Rrul Asfalti Benford gome-gome me peshe operative 16Ton me nr. Identifikues PPI181756.
- Makineria tip Graider Gradall me nr.identifikimi PGT77818B dhe Makineria tip Rrul Bomag gome-gome me nr.identifikimit 332GZ66 jane te angazhuara ne kontrata te tjera me ARRSH.
- Rimorkiatoret me targa AA813RL, AFR286, AFR290 ne baze te dokumentacionit te paraqitur nuk plotësojnë kriterin e peshëmbajtjes prej 30Ton te kërkuar ne DST.
- Kamioncine deri ne 3.5 ton ATP me targe AA688AS nuk disponon police sigurimi aktive te mjetit.
- Autobitumatrice me Targe AA230UL marre me qira me kontrate rep.6792 kol.5138 nuk disponon certificate transporti mallrash te rrezikshme sipas legjislacionit përkatës. (certifikata e qiradhënësit eshte per llogari te vet dhe jo per te trete/Qira)
- Operatori ekonomik ka mare me qira mjete nga kompania “Mirusha Company” e regjistruar ne Kosove nëpërmjet kontratës te lidhur ne noterin publik Shqiptar rep.6817 kol.5172.

Procedura e legalizimit është e detyrueshme për të gjitha dokumentet e lëshuara nga administrata shqiptare që do të përdoren pranë administratave të shteteve të tjera, apo ato të lëshuara nga administrata e një shteti tjetër që do të përdoren pranë administratës shqiptare. Ajo konsiston në njohjen formale nga punonjësit konsullorë, të vulës dhe nënshkrimit të autoritetit që e ka lëshuar dokumentin. Kjo e bën dokumentin njësoj të vlefshëm, nga pikëpamja ligjore edhe jashtë territorit të vendit ku është lëshuar. Shqipëria, sikundër edhe Kosova janë anëtare të Konventës së Hagës “Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja” të 5 tetorit 1961, që do të thotë se dokumentet shqiptare që do të përdoren në vendet anëtare të së njëjtës Konventë, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore. Në bazë të kësaj Konvente, dokumentet pajisen me një vulë Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dhe më pas mund të përdoren direkt në institucionin përkatës të vendit pritës. Sa më sipër operatori ekonomik “GECI ” sh.p.k. ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentacionin ligjor të lëshuar në Republikën e Kosovës (konkretisht leje qarkullimi, siguracion, akte zhdoganimit për mjetet ne pronësi te qeradhenesit Mirusha Company), akte te cilat jane ne kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nuk përmbajne vulë Apostille, çka sjell si pasojë pavlefshmërinë e këtij dokumentacioni për përdorim pranë administratës Shqiptare mjetet e mëposhtme:

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton

03-705-GN, 03-937-ET, 03-212-DT, 03-975-GN, 03-542-EL

Autobetoniere 03-112-GH, 03-113-GH, 03-336-EO, 03-795-FT.

Kamioncine deri ne 3.5 ton 03-543-FT, 03-717-FF

Rimorkiator mbi 30 ton 03-632-XB, 03-640-XB



Sipas nenit 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira, fakt që ben që këto automjete edhe nëse do ishin pajisur me vulën apostile nuk do të mund të transportonin mallra për operatorin ekonomik.

Mjetet e mëposhtme nën të njëjtin arsyetim nuk janë të vlefshëm për shkak të mungesës së vulës apostile.

Cecik hidraulik 2 cope, ekskavator me goma 2 cope, minifadrome bobcat, miniekskavator kubota, ekskavator me zinxhir 5 cope, autopompe betoni 2 cope, Buldozer Cat 2 cope, Asfaltoshtruese 1 cope, Graider Cat 2 cope.

- Operatori ka dështuar të plotësojë pikën 2.3.4/b) Kushtet e veçanta/Stafi ndihmës për 1(nje) Inxhinier Topograf/Gjeodet. Kandidati i propozuar nga O.E. është diplomuar për Inxhinieri Gjeoinformatike (master shkencor Inxhinieri e Burimeve Natyrore).
- Punët e ngjashme të depozituara nga operatori nuk përmbushin kriteret sipas pikës 2.3.1/a dhe 2.3.1/b pasi operatori nuk tregon eksperiencën e nevojshme për të realizuar punimet për ndërtimin e një rruge në disnivele të kategorisë A (dukshëm shumë herë me komplekse sesa puna e ngjashme e depozituar). Operatori ka eksperiencë të konsiderueshme për objektet civile ndërsa për punët e ngjashme të ngarkuara në sistemin elektronik Operatori dëshmon se punimet në infrastrukturën rrugore janë të tipologjisë së rehabilitimeve/mirembajtjeje dhe sistemim asfaltim. KVO arsyeton se eksperiencën në tre vitet e fundit në tipologjinë e ndërtimit të rrugëve është e domosdoshme referuar kompleksitetit të projektit.

IV. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “VEGA & Alko IMPEX GENERAL CONSTRUCTION dshh”, nuk kualifikohet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit, arsyet e skualifikimit janë:

- 1. Skualifikohet bashkimi i operatoreve ekonomik “ Vega + Alko impex general construction “** sepse nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DT dhe bazës ligjore në



fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP . Operatori VEGA pjese e bashkimit te operatoreve ekonomik , nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit pika 1, germa “ gj” e shtojces 12 te dst , me vertetimin e debise se FSHU nr 9657/1 date 30.10.2020 , rezulton qe subjekti Vega shpk te kete ne total 8.817.479,39 leke detyrime per faturat e energjise elektrike , vlere e llogaritur deri ne date 29.10.2020 , perfshire faturen koherente te muajit shtator 2020, vlere qe eshte ne marreveshje aktive

Gjithashtu operatori VEGA pjese e bashkimit te operatoreve ekonomik , nuk permbush kriterin e pergjithshem , te kualifikimit pika 1, germa “ d ” e shtojces 12 te dst. Autoritetit Rrugor Shqiptar i eshte komunikuar nga ana e Drejtorise se Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore te Papaguara , me ane te shkreses nr.9029 prot.,date 12.11.2020 “Kerkese per kalim fondi “, protokolluar ne ARRSH me nr.8778 prot.,date 13.11.2020, kerkesa per kalimin e shumes prej 13.088.041 lekë per shlyerjen e detyrimeve tatimore te papaguara te tatimpaguesit “ Vega “ sh.p.k. Autoritetit Rrugor Shqiptar i eshte komunikuar nga ana e Vega sh.p.k , me ane te shkreses nr.669-2020 prot.,date 19.11.2020 “Riperseritje kerkese per celje garancie“, protokolluar ne ARRSH me nr.9066 prot.,date 23.11.2020 ku pranon faktin qe eshte debitor ndaj buxhetit te shtetit ne shumen 13.088.041 lekë per shlyerjen e detyrimeve tatimore . Keto shkresa e bejne deklaraten sipas shtojces 8, te subjektit Vega shpk te pavlefshme ku subjekti Vega shpk , deklaron se ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e tatimeve e te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas legjislacionit ne fuqi.

2. Punet e ngjashme te depozituara nga BOE nuk permbushin kriteret sipas pikes 2.3.1/a dhe 2.3.1/b pasi operatori me perqindjen me te madhe te pjesemarrjes nuk tregon eksperiencen e nevojshme (edhe ne vlere monetare edhe ne tipologji) per te realizuar punimet per ndertimin e nje nyje rrugore ne disnivel te kategorise A (dukshem shume here me komplekse sesa puna e ngjashme e depozituar). KVO arsyeton se eksperiencia ne tre vitet e fundit ne tipologjine e ndertimit te rrugëve eshte e domosdoshme referuar kompleksitetit te projektit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ **ALB BUILDING**”, me **NUIS: J69102508C** dhe me adrese **TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Asim Vokshi, ndertesa nr.14, hyrja 4, apartamenti 6, kodi postar 1016**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1.402.652.826,75 (nje miliard e katerqind e dy**



milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e teteqind e njetë e gjashtë presje shtatedhjet e pese) Leke është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 223448, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **[1.417.963.621,20]** siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.12.2020

Ankesa : Ankesa Po , ka mare pergjigje me 16.12.2020 dhe date 18.12.2020.

Konceptoi: M. Skurti

Miratoi: V.Hodaj

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Verdho

